AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

20-vjetori i Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane (ECoP)

11.11.2025

Më 6–7 nëntor 2025, në selinë e Komisionit Evropian në Bruksel u mbajt Konferenca me rastin e 20-vjetorit te Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane (ECoP) — një kornizë e përbashkët me 16 parime që udhëheqin zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare në mbarë Evropën.

Nga Agjencia e Statistikave të Kosovës pati nderin të marrë pjesë në këtë ngjarje të rëndësishme, Drejtori Ekzekutiv, Avni Kastrati, duke rikonfirmuar përkushtimin e ASK-së për zbatimin e plotë të parimeve të ECoP-it. Takimi, i organizuar nga Eurostat, shërbeu si një mundësi e vlefshme për shkëmbimin e përvojave, forcimin e bashkëpunimit dhe avancimin e integrimit të Sistemit Statistikor të Kosovës në Sistemin Statistikor Evropian (ESS).

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Ky përvjetor përfaqëson dy dekada përkushtimi ndaj cilësisë, transparencës dhe besimit në statistikat evropiane, duke theksuar rolin e tyre thelbësor, si bazë për hartimin e politikave të bazuara në prova dhe për një debat publik të informuar.